



NJË PËRFUNDIM LOGJIK

Nuk do të kishte kuptim liria po mos të ishte robëria, nuk do të kishte kuptim bashkimi po mos të ishte ndarja, nuk do të kishte kuptim adhurimi po mos të ishte urrejtja!

Duke u nisur nga fakti i thjeshtë të një shënimi të ditëlindjes së Enver Hoxhës, udhëheqësit të shtetit Shqiptar. Këtë ditë e kujtoi edhe vet TVSH- sot në emisionin e saj të mëngjesit me titull : " Udhëtim në kujtesë", për habinë time në këtë emision Enver Hoxhën, ata të TVSH-së, nuk u etiketua as nuk u sha si Diktator etj., siç e etiketuan dhe e shanë të gjithëditurit Haxhiu, Matoshi, Buzhala, Spahiu, Mufaili e xhambaz të tjerë!

Është jo pak domethënës fakti se e shara bie vetëm në gojën e të ligjeve madje këto lloj veglash muzikore të akorduara prej kohësh, që tingujt e pa artikuluar t'i nxjerri sipas shijeve të Beogradit, sikur janë mishëruar dhe nuk shqiten dot nga fyerja dhe mohimi i figurave të kombit tonë. Madje, madje, këta gojëndyrës janë në garë se kush po del i parë në të sharë!

Për aq sa unë mbajë mend, këta ndyrës, nuk kanë thënë as edhe një fjalë deri me sot se Tito ishte diktator, satrap e shtypës i popullit shqiptarë në Kosovë e më gjerë, në as një rast, as kur është bartur stafeta e tij, as kur është shënuar ditëlindja e tij, as kur ka vdekur, as kur është varrosur, as në ndonjërin nga përvjetorët e tij, madje, madje në një formë, apo tjetër edhe kanë marrë pjesë në këto ceremoni për Titon!... Ka vite që shtypi Serb me gazetatat e tij si: "Politika", "Borba", "Nini" etj. Më nuk merret me, Enverin as me Shqipërinë dhe politikën e saj, madje as nuk i shajnë më- thjesht për faktin se ka argatët e vet në Kosovë të cilët janë vënë në garë për të sha Enverin, Shqipërinë dhe bijtë e saj të denjë të cilët me sakrificat e tyre sublime, rrënuan ish sistemin Titist me LKJ-në në krye dhe themelet e tija që kishte ngritur në Kosovë me ndihmën e shërbëtorëve gjakprishur!

Bijtë tanë lanë lëkurën nëpër kazamatët Serbe, lanë atje vitet më të bukura të rinisë, qëndruan atje ballë lartë e të patundur në të drejtën e popullit shqiptarë për të qenë të lirë, mbetur padrejhtësisht jashtë trungut të saj. Krejt natyrshëm ata kishin idol figurat e ndritura të Rilindjes sonë kombëtare, nënën Shqipëri me në krye Enver Hoxhën se një ditë do të fitoni lirinë për të cilën ishin gjakosur breza të tërë.

Tani shtrohet pyetja, pse ata kishin idol Enver Hoxhën të cilin përkujtojnë sot: Pa dyshim se Enveri ndihmoi dhe mbështeti popullin shqiptarë në Kosovë e më tej me të gjitha mundësit e kohës që ai kishte si: Me këngë, me folklor, me literaturë, me ligjërim të profesorëve, me shkrime, me media dhe me qëndrime politike. Kjo mbështetje nga udhëheqësi i Shqipërisë Enver Hoxha, Kosovën e ka shpëtuar pa u tjetërsua nga identiteti i vet kombëtarë.

Krejt natyrshëm dhe logjikshëm është që ata sot kujtojnë idilin e tyre, ruana zot, sikur ata ta kishin idol Titon, pa dyshim se as nuk do të dënoheshin e as persekutoheshin, prandaj mos është e tepër gjithë kjo sharje e vet- vetës sonë?!

Mendoj se turp e tradhti do të ishte për Jakup Krasniqin, Hydajt Hysenin e Berat Luzhën me shokë, sikur në kënaqet e tyre të gjendej fotografia e Titos (që ende disa në Kosovë e mbajnë me nostalgji në zemër), dhe sikur këta të merrnin pjesë në përvjetorin e tij dhe në akademitë që organizohen për nder të poltronëve e sahanlëpirësve titist! Aq më keq do të ishte që subjekti që këta i takojnë të mbante në sjetullat e veta nostalgjikët titist!

Kokën lartë gjeneratë idealiste, që me sakrificat më sublime rrugës së aspiratave të Rilindëseve tanë, me këngët e Enverit në gji, lindën bijtë e këtyre trojeve të rreshtuar në radhët e UÇK-së, që lirinë e një pjese të tokave shqiptare po e bëjnë realitet. Kjo gjeneratë nuk ka sharë as edhe një herë bijtë e aq më larg udhëheqësit e popullit të vet, as nuk i ka quajtur ata ballistë, as diktator, as irredentist e separatistë, as të frustruar, madje që nga koha e Millesh Kopiliqi e deri tek koha e Adem Jasharit (me gjithë Enver Hoxhën brenda), kjo gjeneratë ka sharë dhe ka luftuar vetëm pushtuesin dhe shërbëtorët e tij të cilët edhe në kohë lufte kishin marrë guximin e kishin dalë maleve të Qyqavicës, jo për të luftuar, por për të bindur pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të dorëzonin armët e të mos e luftonin Serbinë e Millosheviqit!...

Si përfundim logjik, nuk do të kisha komentuar më shumë, lë të shajnë të ligjtë, ata dhe paraardhësit e tyre kanë sharë Millesh Kopiliqin se ka vrarë Sulltanin e madh, kanë sharë Qerqizin me Bajon se po prishin Babëdovletin, kanë sharë Oso kukën e Jakup Ferrin se po ia prisnin pushtuesit asqerin, kanë sharë Currin e Boletinin, kanë sharë Nolin, Qemalin e Prishtinën, kanë sharë Polluzhën se po prishte komunizmin, kanë sharë Demaqin e Gërvallën që po prishnin vëllazërim - bashkimin, kanë sharë Enverin, Alinë e Salën, kanë sharë madje edhe Çlirimtarën , kanë sharë Komandantin legjendar- (i kemi dëgjuar me vesh), të jesh gjallë a mos të jesh?!...

16. 10. 2008
Mehmet BISLIMI